



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.31.1-2012-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMISIONIT TË PAVARUR**  
**PËR MINIERA DHE MINERALE**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012**

**Prishtinë, Maj 2013**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti mbështetur nga Astrit Bllaca (Udhëheqës i ekipit), Alban Beka, dhe Arian Haxha.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e Përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	10
5 Sistemi i auditimit të brendshëm .....	20
6 Konkluzioni i përgjithshëm .....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	22
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	24

---

# Përmbledhje e Përgjithshme

## Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave financiare vjetore (PVF-të) e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ( më tutje KPMM) për vitin 2012. Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e bordit dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare;
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

## Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë (ISSAI 400 Opinion i Pakualifikuar).*

## Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

KPMM ka arritur të ndërtoj sistem adekuat të kontrollit të brendshëm. Politikat dhe procedurat aktuale kanë ofruar funksionimin efektiv të kontroleve menaxheriale në një

---

numër fushash të llogarive. Këto procese kanë siguruar informata të plota dhe të sakta për prodhimin e PVF të cilësisë së mirë, të cilat mbështesin vendimmarrjet e menaxhmentit. Më tutje, kanë siguruar që furnizimi me mallra dhe shërbime të kryhet duke respektuar parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar.

Megjithatë, testimet e kryera kanë identifikuar mangësi në disa fusha të menaxhimit financiar dhe kontrollit, siç janë menaxhimi të hyrave, të arkëtueshmeve dhe në fushën e personelit. Mangësitë janë të shpjguara më në detaje më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin KPMM në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të KPMM-së dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

### **Rekomandimet tona kryesore janë:**

#### **Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli**

- Me rastin e hartimit të buxhetit të bëhen analiza të hollësishme, të identifikohen nevojat reale dhe të llogariten kostot sa më të përafërta për projektet kapitale;
- Të forcohen kontrollet në fushën e të hyrave për të siguruar që afatet kohore të parapara me ligj për lëshimin/shqyrtimin e licencave janë respektuar. Më tutje, KPMM duhet të siguroj që nuk i ka lëshuar licencë asnjë operatori ekonomik i cili nuk i ka kryer të gjitha obligimet financiare;
- Të ndërmerren masat konkrete në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, për të siguruar që transaksionet për paga të punonjësve dhe procedurat e rekrutimit kryhen në pajtim me kërkesat në fuqi; dhe
- Në mënyrë aktive t'i merr parasysh të gjitha alternativat tjera, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar që operatorët ekonomik i kanë paguar të gjitha borxhet ndaj KPMM-së.

#### **Sistemi i Auditimit të Brendshëm**

- Të përgatitet plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga NjAB.

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

---

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e KPMM-së të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për KPMM. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera, më pak të rëndësishme që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të rëndësishme** - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

**Të tjera** - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar

---

## 2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Një numër i deklaratave kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

#### **Konkluzioni i Përgjithshëm**

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. KPMM ka përdorur formatin standard për raportim, dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat në pajtueshmëri me kornizën për raportim.

#### **Përshkrimi**

Pasqyrat vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura gjatë auditimit të 9 mujorit në lidhje me kornizën raportuese në memon tonë të datës 14/12/2012 janë adresuar nga Menaxhmenti.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

### Konkluzioni i përgjithshëm

Kemi analizuar cilësinë e informatave të prezantuara ne PVF, ne vlerësojmë se PVF janë të plota dhe të sakta si dhe janë dhënë shpalosjet e duhura.

### Përshkrimi

Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF në draft PVF-të e dorëzuara në Qeveri japin pikëpamje të drejtë dhe të vërtetë.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë (ISSAI 400 Opinion i Pakualifikuar)*.



---

## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### Konkluzioni i përgjithshëm

KPMM ka ndërmarrë masa për adresimin e rekomandimeve tona. Megjithatë, deri në përfundim të vitit 2012, shkalla e adresimit të rekomandimeve nuk është në nivel të kënaqshëm, duke marr parasysh se ishin vetëm tri rekomandime.

### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2011 të KPMM-së kishte rezultuar në 3 (tri) rekomandime kryesore. KPMM ka përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Në fund të auditimit tonë për 2012, KPMM ka adresuar vetëm rekomandimin lidhur me mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare. Rekomandimi i dhënë lidhur me zhvillimin e softuerit për të hyrat, sipas KPMM-së do të implementohet në vitin 2013. Rekomandimi për implementimin e marrëveshjeve për shlyerjen të borxheve ka gjetur zbatim pjesërisht. Këtë e ka konstatuar edhe NjAB që ka bërë auditim të veçantë për këtë çështje. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

---

### 1. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - i rëndësishëm

<b>E gjetura</b>	Rekomandimi i dhënë për implementimin e marrëveshjeve për shlyerje të borxheve ka gjetur zbatim pjesërisht (për më detale shih nën kapitullin 4.6.2 Trajtimi i të Arkëtueshmeve).
<b>Rreziku</b>	Kjo ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin 2011.
<b>Rekomandimi 1</b>	Të adresohet çështja e implementimit të marrëveshjeve të dakorduara me operatorët ekonomik për shlyerjen e borxheve të mëhershme dhe atyre aktuale.

---

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarrë nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky mund, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se në përgjithësi, KPMM ka arritur të dizajnoj një sistem të kënaqshëm të kontrollit të brendshëm. Megjithatë ne kemi identifikuar mangësi ne funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e të hyrave dhe fushën e personelit, të cilat janë paraqitur në brendësi të këtij raporti. Mangësitë e vërejtura mund të rezultojnë në mos arritjen e objektivave të përcaktuara.

### 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Realizimi i buxhetit në masë prej 84% është tregues që planifikimi dhe realizimi i buxhetit në KPMM ka vend për përmirësim, me theks të veçant planifikimi dhe realizimi i projekteve kapitale.

#### Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për KPMM, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

**Tabela 1 Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Burimet e Fondeve	1,695,564	1,505,564	1,262,384	1,279,209	1,398,602
Granti i Qeverisë-Buxheti	1,695,564	1,505,564	1,262,384	-	-
Të hyrat vetanake <sup>2</sup>	-	-	-	1,279,209	1,398,602

---

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 1 tregon që KPMM për vitin 2012 ka shpenzuar vlerën prej 1,262,384€ apo 84% të vlerës së përgjithshme të buxhetit. Buxheti fillestar është zvogëluar gjatë rishikimit për shumën prej 190,000€. Ky zvogëlim është bërë me kërkesë të KPMM-së.

**Tabela 2 Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në euro)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,695,564	1,505,564	1,262,384	1,279,209	1,382,602
Pagat dhe Mëditjet	615,801	615,801	606,181	599,757	558,595
Mallrat dhe Shërbimet	473,763	473,763	390,594	427,462	500,635
Komunalitë	36,000	36,000	34,816	23,084	28,652
Subvencionet dhe Transferet	20,000	-	-	1,130	19,749
Investimet Kapitale	550,000	380,000	230,793	227,777	290,970

Tabela nr. 2 tregon shpenzimin dhe ndryshimet e buxhetit nëpër kategori. Shpenzimi i buxhetit në kategori ekonomike është prezantuar në vijim:

- Buxheti për kategorinë paga dhe mëditje është shpenzuar në vlerë prej 606,181€ apo 98%;
- Buxheti për kategorinë mallra dhe shërbime ishte realizuar në vlerë prej 390,594€ apo 82%. Në krahasim me vitet paraprake vërehet trendi i uljes së shpenzimeve në këtë kategori;
- Buxheti për kategorinë shërbime komunale ishte shpenzuar në vlerë prej 34,816€ apo 97%;
- Buxheti për kategorinë investime kapitale ishte shpenzuar në vlerë prej 230,793€ apo 61%;

Gjatë vitit 2012, buxheti i KPMM-së ka pësuar ndryshimet në vijim:

- Në kategorinë e subvencioneve me rishikimin e buxhetin, ndarja fillestare prej 20,000€ ishte marrë plotësisht me kërkesë të KPMM-së, pasi që nuk kishte projekt të caktuar në këtë kategori; dhe

<sup>2</sup> Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

- Në kategorinë investime kapitale, shkurtimi i buxhetit në vlerë prej 170,000€ lidhet me tri (3) projekte të cilat nuk ishte e mundur që të realizohen. Projekti i parë kërkohet të hartohet në përputhje me Strategjinë e Minierave, e cila ende nuk ishte aprovuar në Kuvend. Projekti i dytë, skaner robotik ka dështuar për shkak të ofertave të larta në raport me planifikimin e shpenzimit. Ndërsa, 50% të ndarjes fillestare buxhetore të projektit për licenca për nevojat e GIS, janë kursyer për arsye të mos realizimit të ueb faqes.

**Tabela 3 Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në euro)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat nga licencat			6,413,535	7,840,765	8,460,537

Tabela 3 tregon që KPMM për vitin 2011, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 6,413,535€. (për më tepër shiko kapitullin 4.4 Të hyrat).

## 2. Çështja - Planifikimi dhe realizimi i projekteve kapitale - Prioriteti-i rëndësishëm

<b>E gjetura</b>	KPMM në planifikimin e buxhetit fillestar kishte paraparë projektin kapital "Skaner robotik". Ky projekt kishte dështuar për shkak të ofertave të larta në raport me planifikimin e shpenzimit.
<b>Rreziku</b>	Mungesa e analizave të nevojshme lidhur me koston e projektit për skaner robotik ka ndikuar, që KPMM të mos arrij objektivat e përcaktuara në fillim të vitit.
<b>Rekomandimi 2</b>	Me rastin e hartimit të buxhetit të bëhen analiza të hollësishme, të identifikohen nevojat reale dhe të llogariten kostot sa më të përafërta për projektet kapitale.

---

## 4.3 Kërkesat e Raportimit

### Konkluzioni i Përgjithshëm

Nga pikat e paraqitura më poshtë konkludojmë që KPMM ka vepruar në pajtim me kërkesat për raportim të jashtëm.

### Përshkrim

Gjatë vitit 2012 KPMM ka përmbushur përgjegjësitë për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportin e performancës për vitin 2011;
- Draft Plani dhe Plani përfundimtar të prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Konkluzion i Përgjithshëm

Në fushën e të Hyrave, kontrollet e pritshme nuk kishin funksionuar siç ishin paraparë. Kjo paraqet një mangësi në kornizën e kontrollit, dhe ndikon në nivelin e realizimit të të hyrave.

### Përshkrimi

Sipas Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative, KPMM ka për detyrë të lëshojë dhe të administrojë të gjitha lejet dhe licencat për shfrytëzimin e pasurive minerale. Ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale në Kosovë.

---

Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale, ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me këtë ligj.

Personi i cili dëshiron të pajiset me licence duhet t'i paraqesë KPMM-së një kërkesë të plotësuar për marrjen e Licencës e cila bëhet në formën e paraparë së bashku me pagesën e taksës, dhe bashkëngjiten dokumentet e kërkuara nga KPMM.

Brenda tre (3) muajve nga pranimi i kërkesës së plotë nga një aplikues i kualifikuar, KPMM-ja ose e lëshon Licencën e kërkuar ose i dërgon aplikuesit vendimin për refuzim.

Nëse KPMM-së i nevojitet më shumë kohë për shqyrtimin e kërkesës, para skadimit të periudhës së përcaktuar tre (3) mujore, do t'i dërgojë aplikuesit të kërkesës një njoftim me të cilin informohet mbi nevojën e KPMM-së për më shumë kohë. Në raste të këtilla, KPMM ka dy (2) muaj shtesë për hulumtim, dhe një 1 muaj për shfrytëzim që ta lëshojë Licencën, ose t'i dërgojë aplikuesit të kërkesës vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për licencë.

Gjatë vitit 2012, KPMM ka lëshuar 44 licenca hulumtimi si dhe 28 licenca shfrytëzimi, si dhe ka riaktivizuar 10 licenca shfrytëzimi të cilat në vitin 2011 me vendim të Qeverisë Nr. 02/46 janë pezulluar. Këto licenca kishin të bënin me eksploatimin e materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve.

Gjatë vitit 2012, KPMM kishte inkasuar 6,413,535€. Mirëpo prej tyre vetëm 3,815,120€ kanë të bëjnë me faturimet e vitit 2012. Pjesa tjetër prej 2,598,415€ ndërlidhet me faturimet e viteve paraprake.

---

### **3. Çështja - Tejkalmi i afateve ligjore për lëshimin/shqyrtimin e licencave për hulumtim/shfrytëzim - Prioriteti - i rëndësishëm**

#### **E gjetura**

Nga 44 licencat e lëshuara për hulumtim, në 21 raste është tejkaluar afati maksimal ligjor prej 5 muajsh, dhe në 3 raste kemi vërejtur se aplikimi për licencë ishte bërë në vitin 2009.

Nga 28 licencat e lëshuara për shfrytëzim, në 19 raste është tejkaluar afati maksimal ligjor prej 4 muajsh, në disa raste kemi vërejtur se aplikimi për licencë ishte bërë në vitin 2009/2010.

Sipas KPMM-së arsyeja e vonesës është mos kompletimi i dokumentacionit nga OE. Për këtë qëllim, KPMM me datën 18.06.2012, ka nxjerr një vendim duke saktësuar se aplikacionet pranohen vetëm të kompletuara me pëlqime nga autoritetet përkatëse.

---

**Rreziku** KPMM nuk ka respektuar afatet kohore të parapara me ligj për lëshimin e licencave. Këto vonesa vënë në dyshim validitetin kohor të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit në kërkesën fillestare. Kohëzgjatja e madhe e shqyrtimeve dhe korrespondencave me kompanitë, mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave të KPMM-së.

**Rekomandimi 3** Të ndërmerat masat konkrete për shqyrtimin e licencave brenda afateteve të parapara me ligj.

#### **4. Çështja - Lëshimi licencës pa kryer obligimet financiare - Prioriteti - i rëndësishëm**

**E gjetura** Gjatë testimit të lëshimit të licencës kemi vërejtur se një kompani nuk i kishte përmbushur kërkesat ndaj KPMM-së. Në datën kur është lëshuar licenca nga KPMM-ja, kompania kishte obligime financiare në vlerë prej 36,736€.

**Rreziku** Mos respektimi i kërkesave të percaktuara nga ana e KPMM-së gjatë lëshimit të licencave mund të ndikoj në mos arritjen objektivave në mënyrë efikase të institucionit.

**Rekomandimi 4** Rekomandojmë KPMM-në që të mos lëshoj licencë asnjë operatori ekonomik pa i kryer paraprakisht të gjitha obligimet financiare ndaj KPMM-së.

## **4.5 Shpenzimet**

### **Konkluzion i përgjithshëm**

KPMM i kupton nevojat e kontrolleve të forta të sistemeve në këtë fushë. Pavarësisht kësaj, kërkohet zhvillim i mëtejshëm në fushën e kontrolleve të personelit dhe menaxhimit të pasurisë.

#### **4.5.1 Prokurimi**

##### **Përshkrim**

Zyrtari i prokurimit kishte hartuar planin e prokurimit për vitin 2012 konform kërkesave ligjore. Bazuar në këtë plan, KPMM kishte nënshkruar 42 kontrata. Nga 16 kontratat e nënshkruara sipas kuotimit të çmimeve tetë (8) prej tyre janë publikuar në web faqen e KRPP-së si njoftime për kontratë.

---

Ne kemi testuar dhe analizuar, zhvillimin e procedurave individuale të prokurimit dhe mënyrën e menaxhimit të kontratave. Nuk kemi gjetur mangësi nga kjo fushë.

## 4.5.2 Shpenzimet tjera

### Përshkrim

Tek Shpenzimet tjera përfshihen të gjitha blerjet që nuk kanë nevojë për procedura të prokurimit. Nga kjo kategori ne kemi testuar shtatë (7) pagesa me vlerë totale prej 33,288€. Testimet tona nuk kanë rezultuar me ndonjë mangësi.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.5.3 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)

### Përshkrim

KPMM për vitin 2012 për kategorinë Paga dhe mëditje kishte buxhet në vlerë prej 615,801€. Ndërsa kishte shpenzuar 606,181€ apo 98% e buxhetit.

Ne kemi testuar transaksionet për paga, dosje të personelit, procesin e rekrutimit dhe kemi krahasuar pagat në kontratat e punës me pagesat e kryera. Testimet tona kanë venë në pah si më poshtë:

---

## 5. Çështja - Ushtrimi i detyrës - Prioriteti - i rëndësishëm

### E gjetura

Bordi i KPMM-së, pas dorëheqjes së Drejtorit të Përgjithshëm, kishte marrë vendim që kjo pozitë të ushtrohet nga kryesuesja e Departamentit Ligjor nga data 15.03.2012 deri në zgjedhjen e Drejtorit të ri. Procedurat për rekrutimin e Drejtorit të ri kishin filluar po të njëjtin muaj, ku bordi kishte kërkuar mbështetje nga MAP në bazë të rregullores nr. 06/2010 (procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në SHCK). MAP kishte shpallur dy herë pozitën në fjalë dhe me datën 17 Dhjetor 2012 kishte dërguar raportin e komisionit të vlerësimit. Kjo ka bërë që pozita e Drejtorit të mbulohet me ushtrues detyre deri në fund të vitit 2012. Sipas ligjit në fuqi pozitën nuk duhet të mbulohen me ushtrues detyre më gjatë se tre muaj.



---

**Rreziku** Mbajtja e pozitave të larta drejtuese me ushtrues detyre mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave të përcaktuara të KPMM-së.

**Rekomandimi 5** Menaxhmenti i KPMM-së duhet të rrit komunikimin me MAP-in që të siguroj që pozitat drejtuese plotësohen me kohë.

#### **6. Çështja – Pagesat e pushimeve të lehonisë - Prioriteti - i rëndësishëm**

**E gjetura** Gjatë testimit të llogaritjes së pagës për pushimet e lehonisë kemi vërejtur se në dy raste me një total të përbashkët prej gjashtë muaj, pagës bazë nuk i janë larguar shtesat. Sipas Rregullores Nr. 06-2011 për pushime në Shërbimin Civil 6 muajt e parë paguhen 70% te pagës bazë. Vlera e llogaritjeve të gabuara është 1,080€.

**Rreziku** Pagesat e kryera në kundërshtim me rregulloren Nr. 06-2011 kanë ndikuar që të dëmtohet buxheti për vlerën e lartëpërmendur.

**Rekomandimi 6** Zyrtarët përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore duhet të instalojnë një sistem të kontrollit të vazhdueshëm për të siguruar që pagat për të punësuarat që janë në pushim të lehonisë të llogariten dhe paguhen konform dispozitave në fuqi.

#### **7. Çështja – Procesi i rekrutimit - Prioriteti - i rëndësishëm**

**E gjetura** Tek procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurimit kemi vërejtur se kandidati i renditur i pari nga komisioni përzgjedhës është tërhequr nga nënshkrimi i akt emërimit. Zyrtarja e personelit ka informuar Drejtorin se duhet të kontaktohet kandidati i cili është i renditur i dyti në listën e kandidateve të përzgjedhur siq e parasheh Rregullorja Nr. 07/2010 për emërimin e nëpunësve civil. Procesi ka mbetur i papërfunduar akoma.

**Rreziku** Mos përmbyllja e procesit të rekrutimit shkakton pozita vakante dhe si rezultat mund të vijë deri te mos përmbyllja e detyrave nga departamenti i prokurimit.

**Rekomandimi 7** Të përmbyllet procesi i rekrutimit konform dispozitave ligjore.

---

## 4.6 Pasuritë

### 4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Gjatë auditimit kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mënyra e mbajtjes së evidencës dhe menaxhimi i pasurive jo financiare në KPMM është kryer konform kërkesave të UA nr.21/2009 mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive Qeveritare.

Vlera neto e pasurive kapitale të KPMM-së, të regjistruara në regjistrin kontabël në fund të vitit 2012 dhe të paraqitura në PVF ishte 1,902,527€.

---

#### Çështja 8 - Inventarizimi i Pasurisë -Prioriteti - i rëndësishëm

##### E gjetura

Sipas UA nr.21/2009, Organizata buxhetore është e obliguar që një herë në vit para përfundimit të çdo viti fiskal të bëjë numërimin fizik apo inventarizimin e gjithë pasurive që janë në posedimin e saj.

KPMM për vitin 2012 nuk kishte arritur të bëjë inventarizimin e pasurisë që ka në posedim siq kërkohet me UA nr.21/2009, deri me datën 13.03.2013.

##### Rreziku

Mos kryerja e inventarizimit në përfundim të vitit fiskal me kohë dhe mos azhurnimi i evidencave shton rrezikun që KPMM të mos ketë informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

##### Rekomandimi 8

Të bëhet inventarizimi i pasurisë në fundvit sipas kërkesës në UA nr 21/2009 me qëllim që të vërtetohet gjendja e gjithë pasurisë në ditën e inventarizimit.

### 4.6.2 Trajtimi i të Arkëtueshmeve

#### Përshkrim

Sa i përket borxheve totale të kompanive ndaj KPMM-së , me 31 dhjetor 2012 ato ishin në vlerë prej 11,192,805€. Me datën e njëjtë të vitit të kaluar ato ishin në vlerë prej 9,550,616€. Kjo tregon një rritje të borxheve prej 1,948,398€ apo 17% më shumë se nga viti i kaluar.

---

Masat të cilat menaxhmenti i ka ndërmarrë për inkasimin e të hyrave është kushtëzimi i operatorëve ekonomik me rastin e aplikimit për licencë dhe kërkesës për minim. Me rastin e aplikimit për licencë ose ripërtëritje të licencës kërkohet nga OE që t'i shlyej borxhet ndaj KPMM-së ose të hyj në marrëveshje për programimin e borxhit.

Gjatë vitit 2012, janë proceduar në Gjykatat kompetente 81 vendime në procedure përbarimore në vlerë prej 1,449,044€.

---

## 9. Çështja - Pagesa e borxheve -Prioriteti - i rëndësishëm

<b>E gjetura</b>	Borxhet e operatorëve ekonomik kanë tendencë rritjeje. Krahasuar me vitin e kaluar këto borxhe janë rritur për 1,948,398€ apo 17%.
<b>Rreziku</b>	Përkundër masave të ndërmarra nga KPMM, ende ekziston rreziku që OE të cilët kanë borxhe dhe nuk aplikojnë për licencë apo për minim, atëherë mundësia për arkëtimin e këtyre borxheve të jetë e vogël. Kjo mund të rezultoj në një humbje të drejtpërdrejtë financiare për KPMM-në.
<b>Rekomandimi 9</b>	Menaxhmenti duhet që në mënyrë aktive t'i merr parasysh të gjitha opsionet, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se borxhet do të arkëtohen.

## 4.7 Trajtimi i Borxheve

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

KPMM në vitin 2012 ka raportuar në pajtim me kërkesat për raportimin obligimeve të papaguara të Organizatave buxhetore.

#### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte në vlerë prej 9,689€. Këto detyrime kishin të bënin me faturat e pranuar në fund të vitit dhe janë bartur për t'u paguar në vitin 2013.

#### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 5 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Konkluzion i përgjithshëm

NjAB ka arritur të realizojë auditimet në bazë të planit vjetor, duke i ofruar menaxhmentit gjendjen aktuale të fushave të audituara, si dhe rekomandime për përmirësimin e tyre.

### Përshkrim

Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2012 ishin planifikuar të kryhen pesë (5) auditime, duke përfshirë periudhën 2012. NjAB ka realizuar të gjitha auditimet, si dhe një (1) auditim të jashtëzakonshëm, i cili ishte bërë me kërkesën e menaxhmentit. Plani vjetor i auditimit ishte aprovuar nga Drejtori i KPMM-së.

Ne kemi vlerësuar se këto raporte i kanë ofruar menaxhmentit pasqyrë të qartë për nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

KPMM në shtator të 2011 kishte themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Ky komitet ka mbajtur takime çdo tre muaj gjatë vitit 2012. Në këto takime është diskutuar plani vjetor i auditimit dhe raportet e auditimit. Komiteti i auditimit ka mbajtur proceverbale ku është përshkruar puna e kryer.

---

### 10. Çështja - Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve-Prioriteti - i rëndësishëm

**E gjetura** Në bazë të Ligjit të auditimit, menaxhmenti duhet të ndërmarrë masa për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB. Ne kemi vërejtur se nga ana e menaxhmentit nga 6 (gjashtë) auditimet e kryera, është përgatitur vetëm një plan i veprimit për implementimin e tyre. Ky shqetësim është ngritur edhe nga komiteti i auditimit.

**Rreziku** Mos përgatitja e planit të veprimit nga ana e menaxhmentit mund të shkaktojë mos identifikimin me kohë të veprimeve dhe personave përgjegjës për implementimin e rekomandimeve.

**Rekomandimi 10** Të përgatitet plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga NjAB.

---

## 6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

Në shumicën e fushave KPMM ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm të cilat sigurojnë bazë për përdorim efektiv dhe efikas të parasë publike dhe dhënien e informatave të cilësisë së mirë, të cilat mbështesin vendimmarrjet e menaxhmentit.

Për të gjithë fushat e shpenzimeve, përveç asaj të personelit dhe të hyrave ne kemi qenë në gjendje të marrim siguri nga kontrollet e nivelit të lartë të implementuara nga menaxhmenti.

Ne kemi gjetur se në fushën e të hyrave, kontrollet e pritshme nuk kishin funksionuar siç ishin paraparë për shkak të mos-arkëtimit të të hyrave të pritura. Masat e ndërmarra nga KPMM ende nuk kanë gjetur zbatim të plot. Kjo paraqet një mangësi të madhe në kornizën e kontrollit, e cila potencialisht mund të rezultojë në humbje të të hyrave. Nevojiten veprime të menjëhershme për ta zbatuar një barazim formal të procesit të hyrave.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

---

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht te adresuara	Rekomandimet pjesërisht te adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Të hyrat	1.1 Ka zhvilluar softuerin në përputhje me kërkesat e punës së tyre, dhe 1.2 Janë ndërmarrë masat adekuate për të konstatuar gjendjen faktike të kompanive të cilat nuk kanë deklaruar/dorëzuar raportet tremujore			Rekomandimi i dhënë lidhur me zhvillimin e softuerit, i cili është investim kapital, sipas KPMM-së do të implementohet në vitin 2013
2. Shpenzimet	Ka mbyllur avanset për udhëtime zyrtare brenda afatit të parashikuar me ligj.	Po		
3. Arkëtueshmet	Ka ndërmarr masa aktive për implementimin e marrëveshjeve për shlyerje të borxheve		Rekomandimi i dhënë për implementimin e marrëveshjeve për shlyerje të borxheve ka gjeturë zbatim pjesërishtë.	